

V E N D I M
Nr.204, datë 22.4.1999

**PËR SHPËRBLIMIN E UDHËHEQËSIT SHKENCOR TË DISERTACIONIT DHE TË
ANËTARËVE TË KOMISIONIT TË KUALIFIKIMIT SHKENCOR**

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, me propozimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Udhëheqësit shkencor, të disertacionit, për kohëzgjatjen e përgatitjes së disertacionit, i njihet një ngarkesë prej 90 orësh mësimore në vit, por jo më shumë se 360 orë për tërë periudhën.

2. Udhëheqësi shkencor duhet të raportojë çdo vit për ecurinë e punës së disertantit dhe pjesët e përfunduara të disertacionit duhet të depozitohen pranë shkollës së lartë, institucioneve apo qendrave kërkimore në dosjen përkatëse të kandidatit. Në rast se disertanti nuk realizon detyrën për vitin përkatës udhëheqësi nuk e përfiton të plotë ngarkesën e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi. Në këtë rast masa e ngarkesës përcaktohet nga komisioni i kualifikimit shkencor.

3. Anëtarët e komisionit të kualifikimit shkencor përfitojnë një shpërblim në masën 50 për qind të pagës së titullit "Profesor", ndërsa kryetari i komisionit përfiton një shpërblim në masën 75 për qind të pagës së titullit "Profesor". Komisioni nuk përfiton shpërblim për muajt që nuk mbledhet.

4. Anëtarët e grupeve të punës, të formuara me anëtarët e komisionit të kualifikimit shkencor, për studime dhe analiza të veçanta, të paguhen me orë efektive mësimore, sipas tarifave përkatëse.

5. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko